

VENDIM
Nr. 81, datë 8.2.2017

PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA VLORE, TË DISA OBJEKTEVE DHE TË DISA SIPËRFAQEVE NGA TRUALLI FUNKSIONAL I PRONËS NR. 904, ME EMËRTIM “AKADEMIA E DETARISË”, ME VENDNDODHJE NË SKELË, VLORE, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Vlorë, të disa objekteve dhe të sipërfaqeve truall funksional prej 22 009 (njëzet e dy mijë e nëntë) m² dhe prej 3 690 (tre mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) m², me sipërfaqe të përgjithshme 25 699 (njëzet e pesë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë) m², brenda territorit të pronës nr. 904, me emërtim “Akademia e Detarisë”, me vendndodhje në Skelë, Vlorë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për nevoja urbanistike, për zbatimin e projekteve për ndërtimin e rrugës “Lungomare” dhe për ndërtimin e unazës së qytetit Vlorë.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, date 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, nga prona nr. 904, me emërtim “Akademia e Detarisë”, me vendndodhje në Skelë, Vlorë, sipas planvendosjes, të hiqen sipërfaqet truall funksional prej 22 009 (njëzet e dy mijë e nëntë) m² dhe prej 3690 (tre mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) m², me sipërfaqe të përgjithshme 25 699 (njëzet e pesë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë) m², përfshirë objektet, dhe të shtohen në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kanë kaluar në pronësi ose në përdorim Bashkisë Vlorë.

3. Bashkisë Vlorë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të sipërfaqeve të pronës, të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, ose t’ua japë ato në përdorim të tretëve.

4. Para fillimit të punimeve, Bashkia Vlorë të ndërtojë rrethimin në kufijtë e rinj të pronës, të kryejë spostimin e rrjeteve inxhinierike që prek gjurma e rrugës, sipas parametrave dhe kushteve teknike, duke i kthyer ato në gjendjen e tyre të mëparshme dhe për këtë, ndërmjet Bashkisë Vlorë dhe Komandës së Forcës Detare Durrës të hartohet një aktmarrëveshje.

5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkia Vlorë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

PLANVENDOSJE


Prona nr. 904 "Akademia e Detarise" Skele, Vlore

SISTEMI I KOORDINATAVE GJITHSHËME

480
450



480
200



SHPJEGUESH

Si aqja cpagjllshmc,.....nr90-IS ;17888m¹
(+hihotobJckti ndm=polqç tn.prop)
Siperfaqja qe prekel nga proj<:ku 'rnoges •Lungmna,...-s
S •U/009 m¹

1[33]So, •<u •qe p<d;c:t nga projdli o.....m S 3690 m¹
n• obj nr7 132.3 m¹

Sipttr•<u• qe i mbc:ta pronco nr90-I(SI S2) S 122116m¹.
ku.SI 7 363m¹.S2 4843 m¹

Vija e projektit ltruges l.ungoumre
Vi)a e projektit Urllli

Shintm:

Kjo planvendosje u hartua ne zbatim m
shkreses se Sekrelaritte Pirgijthshem t6
MMNr6523/l dt25.10.2016,sipas
dokumenlacionit teknik u! marte ne arkivin
elGJIU duke hedhur projeklin ederguar ne
men)re elektronike nga Bashkia Vlore per
Unazen eqytetil dhe projelron "Lungom<>re",
si dhe shkresesse PO nr.4260/ l,date
02 ll.2016

479
950

Nillllor 2016

37 350

372600

372750